



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

NJOFTIM

Nr. 2692/18 prot.

Tiranë, më 19.5.2020

**Z. ARBEN MOLLA**

Në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa VII, Neni 162 dhe pas shkresës me Nr. 2692/1, datë 10.4.2020 dhe shkresës me Nr. 2692/2, datë 10.4.2020, “Njoftim mbi detyrimin për t’u paraqitur në punë”, dërguar në adresën Bulevardi “Zogi I”, pallati “Edicom”, shkalla 1, apartamenti 11 B, dhe pasi Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëri njoftimin publik të z. Molla, me shkresën “Njoftim” Nr. 2692/3, të publikuar në faqen elektronike të MBZHR-së dhe në këndin e njoftimit në ambientet e saj, dërguar dhe Njesisë Bashkiake nr. 9, ku z. Molla rezultoi i regjistruar, me shkresën Nr. 2692/4, datë 23.4.2020, “Dërgohet për shpallje publike”, z. Molla nuk u paraqiti në punë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vendosi njoftimin publik të z. Molla si më poshtë vijon:

Në mbështetje të neneve 57 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të Udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, ju njoftojmë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj jush.

Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj jush, është bërë shkak mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 7 ditë pune, pavarësisht njoftimeve përkatëse që MBZHR ju ka bërë në adresën tuaj, në web-in e Ministrisë, në këndin e saj të njoftimit, si dhe nëpërmjet Njesisë nr. 9 ku ju rezultoni i regjistruar, mungesë e cila klasifikohet si shkelje shumë e rëndë, mbështetur në nenin 57, pika 2, shkronja “ç”.

Ju bëjmë me dije se keni të drejtë për të paraqitur me shkrim sqarimet tuaja rreth shkeljeve të pretenduara, të drejtën për paraqitjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve, inspektimin e dosjes, të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues.

Shkelja juaj do të shqyrtohet më datë 5.6.2020, ora 11:00, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa VII, Neni 162, pika 3, bëjmë me dije se ky njoftim, përveç se në këndin e njoftimit në MBZHR dhe në faqen zyrtare elektronike “bujqësia.gov.al”, i është dërguar për shpallje publike Njesisë Bashkiake nr. 9, ku rezulton i regjistruar z. Arben Molla.

Njoftimi shpallet sot më datë 20.5.2020 dhe hiqet më datë 30.5.2020.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

